

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 23

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe aksionerëve të Shoqërisë AYEN ENERGY TRADING sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë **AYEN ENERGY TRADING sh.a**, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuodojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues Ligjor

5 mars 2018



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phonë: +355 42 27 80 25
www.mazars.al , info@ mazars.al

AYEN ENERGY TRADING sh.a
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	60,064,201	60,478,222
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	489,264,282	98,330,475
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6,23	88,905,745	120,285,847
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	91,366,381	44,654,923
Shpenzime të shtyra	8	23,038,991	3,864,827
Totali i aktiveve afatshkurtra		752,639,600	327,614,294
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	4,102,537	5,056,262
Totali i aktiveve afatgjata		4,102,537	5,056,262
Totali i aktiveve		756,742,137	332,670,556
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	65,687,725	68,685,012
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	22,23	593,944,651	208,962,539
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	22	-	88,397,775
Detyrime tatimore	11	2,056,936	762,371
Të tjera detyrime	12	711,297	3,344,894
Totali i detyrimeve afatshkurtra		662,400,609	370,152,591
Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		662,400,609	370,152,591
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000,000	3,500,000
Fitime të mbartura		(40,982,035)	(42,739,509)
Fitimi i ushtrimit		35,323,563	1,757,474
Totali i kapitalit	13	94,341,528	(37,482,035)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		756,742,137	332,670,556

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	1,672,214,679	1,049,738,741
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	2,911,195	(127,863)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(1,604,717,122)	(1,014,012,909)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme	16	(1,590,105,549)	(998,284,179)
Të tjera shpenzime	17	(14,611,573)	(15,728,730)
Shpenzime të personelit	18	(29,316,812)	(29,858,290)
1) Paga dhe shpërblime		(27,585,173)	(28,045,838)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/ shëndetësore		(1,731,639)	(1,812,452)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(1,251,393)	(1,476,859)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(50,000)	(128)
Shpenzime financiare	20	(3,401,058)	(2,505,218)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(807,576)	(865,022)
2) Shpenzime të tjera financiare		(2,593,482)	(1,640,196)
Fitimi/humbja para tatimit		36,389,489	1,757,474
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21	(1,065,926)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,065,926)	-
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		35,323,563	1,757,474
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		35,323,563	1,757,474

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



AYEN ENERGY TRADING sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkuar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim/Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	3,500,000	(18,134,531)	(24,604,978)	(39,239,509)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	1,757,474	1,757,474
Transferimi në rezultatit e mbartur	-	(24,604,978)	24,604,978	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	3,500,000	(42,739,509)	1,757,474	(37,482,035)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	35,323,563	35,323,563
Transferimi në rezultatit e mbartur	-	1,757,474	(1,757,474)	-
Rritja e kapitalit	96,500,000	-	-	96,500,000
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000,000	(40,982,035)	35,323,563	94,341,528

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Ayen Energy Trading sh.a më 5 mars 2018 dhe janë firmosur si më poshtë.

Al Yigit ARMAN

Fahrettin Amir Arman
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	35,323,563	1,757,474
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Interes i përllogaritur	807,576	865,022
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,251,393	1,476,859
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative	2,021,926	(138,338)
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(425,439,327)	(132,111,923)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	325,551,542	120,205,888
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	1,040,409
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(60,483,327)	(6,904,609)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(297,668)	(487,303)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(297,668)	(487,303)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	62,388,900	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	62,388,900	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,607,905	(7,391,912)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	60,478,222	69,065,502
Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(2,021,926)	(1,195,368)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	60,064,201	60,478,222

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Ayen Energy Trading sh.a, është një shoqëri e regjistruar më 25 shtator 2013 si shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka nipt L32130008F. Selia e shoqërisë është Rruga "Papa Gjon Pali i II-të", ABA Business Center, Kati 6, Njësia Bashkiake Nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1000 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK për një vlerë totale 100,000,000 LEK. Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi. Administrator i shoqërisë është Z. Fahrettin Amir Arman.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është sigurimi, transmetimi, shpërndarja, importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumicë ose pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike.

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka 9 punonjës (2016: 10).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkufizuar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17
GBP/LEK	149.95	157.56



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	58,224,062	60,251,351
Mjete monetare në arkë	1,840,139	226,871
	<u>60,064,201</u>	<u>60,478,222</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	489,264,282	98,330,475
	<u>489,264,282</u>	<u>98,330,475</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shuma e kapitalit te papaguar	34,111,100	-
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	54,794,645	120,285,847
	<u>88,905,745</u>	<u>120,285,847</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH e zbritshme	89,648,832	43,714,331
Garanci	1,317,171	938,468
TVSH në doganë	37,843	2,124
Të tjera të arkëtueshme	362,535	-
	<u>91,366,381</u>	<u>44,654,923</u>



8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të shtyra	23,038,991	3,864,827
	<u>23,038,991</u>	<u>3,864,827</u>



AYEN ENERGY TRADING sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Kompjutera	Pajisje zyre	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2016	5,722,024	2,403,921	8,125,945
Shtesa	487,303	-	487,303
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	6,209,327	2,403,921	8,613,248
Shtesa	38,930	258,738	297,668
Riklasifikime	1,354,296	(1,354,296)	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7,602,553	1,308,363	8,910,916
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2016	1,841,065	239,062	2,080,127
Amortizimi i vitit	1,043,887	432,972	1,476,859
Riklasifikime	282,973	(282,973)	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,167,925	389,061	3,556,986
Amortizimi i vitit	1,106,344	145,049	1,251,393
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,274,269	534,110	4,808,379
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,041,402	2,014,860	5,056,262
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,328,284	774,253	4,102,537



10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme tregtare	65,687,725	68,685,012
	<u>65,687,725</u>	<u>68,685,012</u>

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	270,464	250,582
Tatimi mbi të ardhurat personale	422,706	403,208
Tatimi në burim	297,840	108,581
Tatimi mbi fitimin	1,065,926	-
	<u>2,056,936</u>	<u>762,371</u>

12. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga të pagueshme	711,297	3,344,894
	<u>711,297</u>	<u>3,344,894</u>

13. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë është 100,000,000 LEK i zotëruar 100% nga shoqëria mëmë Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi.

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Numri aksioneve	1,000	35
Vlera aksionit (Ne lek)	100,000	100,000
Vlera kapitalit aksionar	100,000,000	3,500,000
Fitimet e Pashpërndara	(40,982,035)	(42,739,509)
Fitim / Humbja e vitit	35,323,563	1,757,474
Kapitali	<u>94,341,528</u>	<u>(37,482,035)</u>

Shoqëria ka humbje të mbartura më 31 dhjetor 2017 në vlerën 40,982,035 LEK (2016: 42,739,509 LEK).



13. Kapitali aksionar (vazhdim)

Në vitin 2017 kompania ka rritur kapitalin e saj bazuar vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme më 18 dhjetor 2017, e cila ka miratuar rritjen e kapitalit nga 3,500,000 LEK në 100,000,000 LEK. Rritja e kapitalit u realizua me lëshimin e 965 aksioneve të reja me vlerë nominale 100,000 lekë/aksion. Aksionari ka paguar 62,388,900 lekë dhe kapitali i mbetur i papaguar është 34,111,100 lekë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme më 18 dhjetor 2017 është depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe është publikuar më 21 dhjetor 2017.

14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shitje energjie	1,528,097,474	1,015,040,579
Tarifë transmetimi	71,379,053	11,534,733
Shitje energjie për konsum	72,738,152	23,163,429
	<u>1,672,214,679</u>	<u>1,049,738,741</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	1,512,542,524
Zbriten faturat e Dhjetorit të vitit të kaluar të deklaruar në Janar të këtij viti	28,722,896
Shtohen diferencat e këmbimit të përfshira në të ardhura të tjera	2,911,195
Shtohen faturat e Dhjetorit të vitit aktual deklaruar në Janar të vitit pasardhës	188,395,051
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,675,125,874
Sipas kontabilitetit	1,675,125,874
Diferenca	-

15. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Fitime nga kursi i këmbimit	10,785,927	6,594,787
Humbje nga kursi i këmbimit	(7,874,732)	(6,918,175)
Të ardhura të tjera	-	195,525
	<u>2,911,195</u>	<u>(127,863)</u>



16. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje energjie	1,466,021,615	950,555,322
Shpenzime për alokim të kapaciteteve	86,293,173	47,667,089
Shpenzime për transmetim	37,790,761	61,768
	1,590,105,549	998,284,179

17. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,171,020	1,292,454
Shpenzime qeraje	3,046,417	2,803,249
Shpenzime për shërbime bankare	1,271,978	1,922,231
Shpenzime ndërmjetesimi	749,317	1,712,378
Transferime, udhëtim dhe dieta	189,114	1,085,809
Shpenzime të tjera ndaj personelit	1,030,390	827,838
Shpenzime energji, avull, uje	186,044	195,893
Shpenzime noteriale dhe konsulence	570,714	734,570
Shpenzime kancelarie	443,099	103,824
Mirëmbajtje dhe riparime	1,617,992	1,507,740
Taksa të tjera	537,781	471,982
Shpenzime ushqimi	1,279,993	1,175,720
Shpenzime program moti	938,646	723,876
Shpenzime shëndeti	349,008	416,292
Shpenzime të tjera	1,230,060	754,874
	14,611,573	15,728,730

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	27,585,173	28,045,838
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,731,639	1,812,452
	29,316,812	29,858,290

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 9 (2016: 10).



19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Gjoka	50,000	128
	<u>50,000</u>	<u>128</u>

20. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga kursi këmbimit nga aktiviteti financiar	-	1,333,706
Shpenzime për huanë	(807,576)	(865,022)
Komision për letër garanci bankare	(2,593,482)	(2,973,902)
	<u>(3,401,058)</u>	<u>(2,505,218)</u>

21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	36,389,489	1,757,474
Shpenzime të panjohura të tjera (si me poshtë)	1,970,522	2,770,006
Shpenzime të tjera personeli	244,807	1,148,836
Penalitet, gjoka e dëmshpërblime	50,000	128
Shpenzime për konsum personal	1,279,993	1,175,720
Shpenzime të tjera	395,722	445,322
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>38,360,011</u>	<u>4,527,480</u>
Humbje fiskale e mbartur	(31,253,836)	(4,527,480)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<u>1,065,926</u>	<u>-</u>



21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Shoqëria ka patur humbje të mbartura për vlerën 35,302,744 Lek nga të cilat janë ulur me 4,048,908 Lek në bazë të njoftimit vleresimiti datë 28.06.2017 me numër protokollit 16238/3-4. Humbjet tatimore të mbartura si paraqiten më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>
Humbje fiskale 2014 (skadojnë në 2017)	13,322,010
Humbje fiskale 2015 (skadojnë në 2018)	21,980,734
	<u>35,302,744</u>
Ulje nga njoftim vleresimi date 28.06.2017	4,048,908
Humbje fiskale për tu përdorur	<u>31,253,836</u>

22. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	-	88,397,775
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	593,944,651	208,962,539
	<u>593,944,651</u>	<u>297,360,314</u>

23. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>		<u>31 dhjetor 2016</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
Ayen Enerji Doo Beograd	54,794,645	-	120,285,847	-
Ayen Electric Ticaret				
Anonim Sirketi	34,111,100	3,105,679	-	89,152,362
Ayen AS Energji sh.a	-	581,990,826	-	208,207,952
AYEN ENERJI A.S Turqi	-	8,844,822	-	-
Ayen Energija Doo				
Slovenia	-	3,324	-	-
	<u>88,905,745</u>	<u>593,944,651</u>	<u>120,285,847</u>	<u>297,360,314</u>



23. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ayen Enerji Doo Beograd	219,728,707	599,854,053	300,869,491	48,666,796
Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi	-	2,628,045	-	761,893
Ayen AS Energji sh.a	3,409,238	596,632,229	24,782,672	413,481,215
Shpenzime interesi Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi	-	-	-	865,022
Ayen Energija Doo Sllovenia	70,304	-	-	-
AYEN ENERJI A.S Turqi	-	8,844,822	-	-
	<u>223,208,249</u>	<u>1,207,959,149</u>	<u>325,652,163</u>	<u>763,774,926</u>

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 1,234,920 LEK (2016: 1,184,154 LEK). Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

24. Manaxhimi i riskut financiar

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që pala tjetër të mos ketë mundësi të paguajë detyrimet e saj të lindura si pasojë e një instrumenti financiar apo një marrëveshje duke sjellë humbje financiare. Ekspozimi nga risku i kreditit vjen nga aktivitete operative. Shoqëria kontrollon riskun e kreditit që lidhet me klientët e saj duke monitoruar vazhdimisht shumat e pambledhura.

Analiza e maturimitit të aktiveve financiare paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2017		
	Deri ne 1 vit	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	624,883,609	44,652,799	669,536,408
Mjete monetare në arkë dhe bankë	60,064,201	-	60,064,201
Totali	684,947,810	44,652,799	729,600,609

Përshkrimi	31 dhjetor 2016		
	Deri ne 1 vit	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	262,332,777	938,468	263,271,245
Mjete monetare në arkë dhe bankë	60,478,222	-	60,478,222
Totali	322,810,999	938,468	323,749,467



24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2017 dhe më 31 dhjetor 2016.

Përshkrimi	31 dhjetor 2017		
	Deri në 1 vit	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	669,536,408	-	669,536,408
Mjete monetare në arke dhe bankë	60,064,201	-	60,064,201
Totali	729,600,609	-	729,600,609
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(662,400,609)	-	(662,400,609)
Hua	-	-	-
Totali	(662,400,609)	-	(662,400,609)
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2017	67,200,000	-	67,200,000

Përshkrimi	31 dhjetor 2016		
	Deri ne 1 vit	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	262,332,777	938,468	263,271,245
Mjete monetare në arke dhe bankë	60,478,222	-	60,478,222
Totali	322,810,999	938,468	323,749,467
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(281,754,816)	-	(281,754,816)
Hua	-	-	(88,397,775)
Totali	(281,754,816)	-	(370,152,591)
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2016	41,056,183	938,468	(46,403,124)

Risku i monedhës

Ekspozimi i shoqërise ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2017 dhe më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2017			
	EUR	GBP	LEK	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	574,789,449	-	94,746,959	669,536,408
Mjete monetare në arke dhe bankë	58,886,823	397	1,176,981	60,064,201
Totali	633,676,272	397	95,923,940	729,600,609
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(638,251,156)	-	(24,149,453)	(662,400,609)
Hua	-	-	-	-
Totali	(638,251,156)	-	(24,149,453)	(662,400,609)
Risku i kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2017	(4,574,884)	397	71,774,487	67,200,000



24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës (vazhdim)

Pershkrimi	31 Dhjetor 2016			
	EUR	GBP	LEK	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	218,332,860	-	44,938,385	263,271,245
Mjete monetare në arke dhe bankë	56,968,130	397	3,509,695	60,478,222
Totali	275,300,990	397	48,448,080	323,749,467
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(277,367,498)	-	(4,387,318)	(281,754,816)
Hua	(88,397,775)	-	-	(88,397,775)
Totali	(365,765,273)	-	(4,387,318)	(370,152,591)
Risku i kursit të kembimit me 31 Dhjetor 2016	(90,464,283)	397	44,060,762	(46,403,124)

Risku i normes së interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes.

Shoqëria ka një hua nga aksioneri i vetëm Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi me norma interesi fikse.

25. Angazhime dhe pasiguri

Më 31 dhjetor 2017 kompania kishte kontrata qeraje operative në lidhje me marrjen me qera të zyrave në Tiranë. Minimumi i pagesave të ardhshme sipas kontratave janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Brenda një viti	3,523,788	2,758,692
Më shumë se një vit por më pak se pesë vite	-	2,528,801
	3,523,788	5,287,493

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

